

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON KOSOVO TRUST AGENCY
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU AGENCIJU

SCC – 10 – 0133

Janar 2011

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
Rruga Ilir Konushevci nr. 8, Prishtinë

Paditësit

kundër

Komunës së Vushtrrisë, Vushtrri

I Padituri

Dhoma e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, Nën-Paneli i përbërë nga Laura Plesa si Gjyqtare Kryesuese dhe Sabri Halili, Gjyqtar, i deleguar nga Trupi Gjykues i përbërë nga Laura Plesa si Gjyqtare Kryesuese, Anna Bednarek dhe Sabri Halili, Gjyqtarë, me urdhrin e datës 15 shtator 2010, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 17 janar 2011 lëshon këtë

A K T G J Y K I M

Padia e Paditësit Agjencisë Kosovare të Privatizimit aprovohet pjesërisht. I padituri është i obliguar që të kthejë në posedim pjesën e tokës së përfshirë në ngastrën e tokës 2254/41 P.L.471 Zona Kadastrale Vushtrri dhe jo të zënë nga shkolla dhe oborri i parashikuar. Pjesa e padisë që ka të bëjë me posedimin e sipërfaqes së tokës prej 1.79.00 ha që ndodhet në ngastrën 2254/41 P.L.471 Zona Kadastrale Vushtrri dhe e zënë nga shkolla dhe oborri dhe kthimi i këtij posedimi në gjendjen e mëparshme refuzohet si e pabazuar.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 23 qershor 2010, Paditësi parashitroi një kërkesë për pengimin e posedimit dhe ndërprerjen e përkohshme të punimeve për ndërtimin e shkollës në ngastrën kadastrale nr. 2254/41, fleta poseduese nr. 471 në Vushtrri.

Paditësi pohon se Ndërmarrja Shoqërore [REDAKTUAR] në Vushtrri (NSH) pranë regjistrat të gjykatës ekonomike nr. fi – 832/89 është në likuidim, dhe pasi që është Ndërmarrje Shoqërore është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Më tej Paditësi pohon se NSH-ja është pronare e ngastrës kadastrale të tokës dhe Paditësi është duke kërkuar të drejtat e NSH-së sipas Nenit 29.2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Ligji Nr. 03/L-067.

Paditësi i parashtroi dokumentet vijuese (të referuara si Shtojca nr. 1):

1. Një kopje të Formularit të Kërkesës së Përcaktimit të Statusit për NSH-në (SDR 441)
2. Një kopje të njoftimit të fillimit të likuidimit dhe caktimit e anëtarëve të parë të komisionit të likuidimit të NSH-së [REDAKTUAR] më 17 mars 2006
3. Fletën Poseduese nr. 471, ngastra kadastrale e tokës nr. 2254/41 me një sipërfaqe prej 04.28.04 ha, në zonën kadastrale Vushtrri.

Paditësi thekson se më 15 shkurt 2010, Zyra Rajonale e Paditësit në Mitrovicë ka kërkuar nga Kryetari i Komunës së Vushtrrisë informata lidhur me dy baraka të cilat ndodhen në ngastrën kadastrale të tokës nr. 2254/41. Paditësi paraqiti një kopje të letrës së drejtuar tek Kryetari i Komunës së Vushtrrisë më datën 15 shkurt 2010 (Shtojca nr. 4).

Paditësi nënvizon se një zyrtar i Zyrës Rajonale të Paditësit në Mitrovicë vizitoi vendin më 24 mars 2010 dhe gjeti se ngastra kadastrale e tokës nr. 2254/41 është e rrethuar nga një rrethojë alumini dhe se punimet ishin duke vazhduar në vendin e ndërtimit. Paditësi paraqiti një kopje të një poste elektronike (e-mail) të dërguar nga zyrtari i lëndës tek anëtarët e Komisionit të Likuidimit të NSH-së më 24 mars 2010 dhe fotografitë e vizitës së vendit (Shtojca nr. 5).

Paditësi thekson se Kryetari i Komisionit për Likuidimin e NSH-së dërgoi një letër tek Kryetari, Z. [REDAKTUAR], më 26 mars 2010, duke kërkuar pezullimin e punimeve që janë në vazhdim e sipër në ngastrën kadastrale të tokës nr. 2254/41 dhe e bashkëngjiti një kopje të kërkesës (Shtojca nr. 6).

Paditësi pohon se më 29 mars 2010, Drejtori për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, Z. [REDAKTUAR], nëpërmjet Kryetarit, Z. [REDAKTUAR], paraqiti kërkesën për shkëmbimin e tokës së ngastrës kadastrale të tokës nr. 2254/41 të NSH-së në Vushtrri për ngastrën kadastrale të tokës nr. 412, fleta poseduese nr. 198, me një sipërfaqe prej 05.52.06 ha në zonën kadastrale Stanofc i Ulët, nën posedimin e Komunës së Vushtrrisë. Paditësi paraqiti një kopje të kërkesës për shkëmbimin e tokës të datës 29 mars 2010 (Shtojca nr. 7).

Paditësi thekson se në pajtim me Nenin 5.1 (a) të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Ligji Nr. 03/L-067, ka autoritet ta administrojë:

- (i) *Ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pavarësisht nëse i janë nënshtruar Transformimit apo jo; dhe*
- (ii) *Të gjitha asetet që ndodhen në territorin e Kosovës, pavarësisht a janë të organizuara si subjekt apo jo, të cilat kanë qenë pronë në pronësi shoqërore më ose para 22 Marsit 1989, pavarësisht nëse i janë nënshtruar Transformimit apo jo, sipas Nenit 5.1 (b) më poshtë; dhe*
- (iii) *Pjesët e Vogla, pavarësisht nëse subjekti përkatës juridik i është nënshtruar Transformimit.*

Përveç kësaj, Paditësi pohon se në bazë të Nenit 29.2 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Ligji Nr. 03/L-067:

Agjencia ka të drejtë ligjore që të kërkojë çfarëdo të drejtash për një ndërmarrje në gjykatën kompetente në emër të asaj ndërmarrje.

Paditësi nënvizon se në pajtim me Nenin 4.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, trupat gjykues të Dhomës së Posaçme duhet të kenë juridiksion parësor për paditë dhe kundërpaditë që lidhen me: *(h) Me kërkesë të Agjencisë, zbatim i kompetencave të Agjencisë në pajtim me Rregulloren nr. 2002/12.*

Paditësi thekson se në pajtim me Nenin 52.1 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2006/17: *Me kërkesë të palës, Dhoma e Posaçme mund të nxjerrë një vendim gjyqësor paraprak nëse pala jep prova të besueshme se dëmi, humbja apo dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm do të kenë pasoja për palën nëse nuk lëshohet vendimi gjyqësor paraprak për atë kërkesëpadi. Kërkesa për vendim gjyqësor preliminar parashtrohet bashkë me kërkesëpadinë ose pas kërkesëpadisë së parashtruar në lidhje me atë kërkesëpadi.*

Paditësi pohon se Komuna e Vushtrrisë, me fillimin e ndërtimit të një godine të shkollës në ngastrën kadastrale të tokës nr. 2254/41, fleta poseduese nr. 471 me një sipërfaqe prej 04.28.04 ha, në zonën kadastrale Vushtrri, pengon posedimin e qetë të pronës nga ana e NSH-së, e përfaqësuar nga Paditësi. Më tej Paditësi thotë se ndërtimi që është në vazhdim e sipër do të rezultojë me humbje të menjëhershme dhe të pariparueshme për NSH-në pasi që ngastra kadastrale e tokës nr. 2254/41 mendohet të shitet me anë të likuidimit dhe prandaj nuk paraqet më një investim atraktiv dhe se ka shkaktuar një humbje të konsiderueshme financiare për kreditorët e NSH-së.

Prandaj Paditësi i kërkon Dhomës së Posaçme të lëshojë një masë të përkohshme kundër ndërtimeve që janë në zhvillim e sipër në ngastrën kadastrale të tokës nr. 2254/41; dhe të gjej se i Padituri ka penguar posedimin e qetë të NSH-së; si dhe ta obligojë të Paditurin ta kthejë pronën në gjendjen e mëparshme, sikurse ka qenë para fillimit të punimeve për ndërtim.

Më 7 korrik 2010, gjyqtari i ngarkuar me lëndën e dërgoi Padinë dhe dokumentet përcjellëse si dhe kërkesën për masën e përkohshme të parashtruar nga ana e Paditësit tek i Padituri me një Urdhër të datës 7 korrik 2010, dhe me kusht që i Padituri do të mund të parashtrrojë një përgjigje ndaj kërkesës për masën e përkohshme brenda 14 ditëve nga dërgimi dhe një mbrojtje ndaj Padisë brenda 1 muaji prej dërgimit të tij.

Padia dhe kërkesa për masën e përkohshme ishte dërguar tek i Padituri më 14 korrik 2010.

Më 28 korrik 2010, i Padituri e parashtrroi një përgjigje ndaj kërkesës për masën e përkohshme, brenda afatit ligjor, ku thotë se kërkesa për masën e përkohshme është e padrejtë, pasi që prona në të cilën është duke u ndërtuar shkolla është pronë publike. I Padituri theksoi se Komuna e Vushtrrisë përballet me mungesën e tokës për ndërtim të objekteve me interes të përgjithshëm publik, si për shkolla, objekte të kulturës dhe për objekte shëndetësore, prandaj Kuvendi Komunal i Vushtrrisë në takimin e mbajtur më 27 mars 2008 ngastrën kadastrale të tokës nr. 2254/41 me një sipërfaqe prej 04.28.04 ha, në vendin e quajtur Selishte, fleta poseduese nr. 471 e ka shpallur pronë e paluajtshme me interes publik dhe drejtori i Kadastrës nëpërmjet kryetarit të komunës i ofroi paditësit shkëmbimin e tokës më 29 mars 2010 në pajtim me Nenin 4,

paragrafin 2 dhe Nenin 5 të Ligjit mbi Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme. I Padituri e paraqiti vendimin e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, nr. 209/08 në takimin e mbajtur më 27 mars 2008 dhe letrën e drejtorit nr. 17/10 të dërguar nëpërmjet kryetarit të komunës më datën 29 mars 2010 dhe ka kërkuar që kërkesa për një masë të përkohshme të pezullohet deri sa të arrihet marrëveshja në mes të palëve.

Më 9 gusht 2010, i Padituri e parashtrroi një përgjigje ndaj padisë dhe nënvizoi se padia nuk është e drejtë, pasi që prona e kundërshtuar është pronë publike. I Padituri theksoi se Komuna e Vushtrrisë ka mungesë të madhe të pasurisë së paluajtshme për ndërtimin e objekteve me interes publik, për të njëjtat arsye të përmendura më lartë.

Më 15 shtator 2010, udhëheqja e procedurës gjyqësore ishte deleguar tek një nën panel i përbërë nga Laura Plesa dhe Sabri Halili në pajtim me Nenin 8.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 dhe Nenin 11 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6.

Më 20 shtator 2010, nën paneli lëshoi një aktvendim me anë të cilit e refuzoi kërkesën për masën e përkohshme si të pabazë. Arsyetimi ligjor theksoi që:

“Fakti i ndërtimit të shkollës në tokën e cila i takon NSH-së nuk kontestohet. Në përgjithësi, pronari i tokës ka të drejtë të kërkojë për ndalimin e çfarëdo cenimi të të drejtave të tij pronësore. Por në këtë shkresë të lëndës lidhjet juridike në mes të palëve rregullohen nga dispozita të veçanta të Rregullores së UNMIK-ut 2006/5. I Padituri është në situatë të Administratës Komunale që kërkon një dhënie të asetit të tokës, tani për tani nën autoritetin administrativ të AKP-së, për qëllime të përfitimit publik (siç parashihet që mund të bëhet nga Rregullorja e UNMIK-ut 2006/5). Deklarata e Paditësit – AKP-së është se i Padituri nuk ka dërguar asnjë dokument që e mbështetë kërkesën e tij për dhënie. Por Agjencia, duke ushtruar kompetencat e veta administrative nuk ka kërkuar asnjë dokument dhe nuk ka lëshuar asnjë vendim sipas kërkesës së Komunës. Kur fillon procedura për vërtetimin e kërkesës për dhënie, do të mund të jetë momenti për AKP-në të ushtrojë një parashtrësë për Masën të Përkohshme për këtë objekt. AKP-ja është autoriteti i cili e ka për obligim ta fillojë këtë procedurë. Kjo është arsyeja se përse në këtë moment, derisa nuk merret aktvendimi me pasojat ligjore nga ana e AKP-së, në procedurën urgjente për Masën e Përkohshme vërtetimi i ligjshmërisë së veprimeve të Komunës nuk mund të bëhet. Aktvendimi i Gjykatës për status quo-në e tokës do të ishte barrë shumë e rëndë për këtë subjekt që ka filluar procedurën administrative – supozohet se me besim të mirë – por nuk ka marrë asnjë përgjigje.

Me urdhrin e datës 15 nëntor 2010, gjyqtari i ngarkuar i ka urdhëruar palët të sqarojnë nëse ndërtimi i shkollës ka ndikim vetëm në ngastrën e kundërshtuar dhe nëse kjo ngastër është nën administrimin e AKP-së. Më tej palët janë urdhëruar të paraqesin informata për atë se sa është sipërfaqja e tokës së ndërtesës dhe sa është sipërfaqja brenda tokës së kundërshtuar e ndikuar nga ndërtesa.

Më 25 nëntor 2010, i padituri e njoftoi gjykatën se sipas dijenisë së tyre ngastra kadastrale nr. 2254/41 është nën administrimin e AKP-së. Më pas është theksuar se ngastra tjetër e përmendur në aktvendimin nr. 209/08 nuk ka ndikim në ndërtimin e shkollës. I padituri gjithashtu ka dorëzuar kopjet e fotografive të ngastrave kadastrale nr. 2254/1 dhe nr. 2254/41.

Gjatë seancave dëgjimore të cilat janë mbajtur më 4, 11 dhe 25 nëntor 2010:

Përfaqësuesit e paditësit shpjeguan se nuk ishte lëshuar asnjë aktvendim formal nga Agjencia në lidhje me kërkesën e Komunës së Vushtrrisë për shkëmbimin e tokës të dorëzuar pranë ZR-së së Mitrovicës për shkak të faktit se komuna ishte obliguar ta dorëzojë kërkesën pranë departamentit civil dhe jo pranë agjencisë. Më tej ata theksuan se kërkesa e komunës për shkëmbimin e tokës ishte dërguar së bashku me një kopje të njoftimit të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe një kopje të kontratës për ndërtimin e godinës së shkollës. Por sipas atyre nuk ishte bashkëngjitur aktvendimi i komunës, me anë të së cilit ngastra e kundërshtuar ishte shpallur me interes të përgjithshëm. Ata gjithashtu e kanë pranuar se ata i kanë mbajtur tre takime me përfaqësuesit e komunës dhe se ata e kanë parë aktvendimin e datës 27 mars 2008 në njërin nga ato takime.

I padituri kërkoi nga Dhoma e Posaçme ta refuzojë padinë si të pabazuar. I padituri pohoi se padia ishte parashtruar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe në veçanti nga Komisioni për Likuidim i ndërmarrjes "██████████" ndërsa prona e kundërshtuar është e regjistruar në emër të fabrikës së konfeksionit "██████████". Sipas të paditurit, prona e patundshme e ish Ndërmarrjes Shoqërore ishte një pronë në pronësi shoqërore, e cila ishte përdorur nga NSH-ja – por vetëm me miratimin e komunës – dhe për ta vërtetuar këtë i padituri tashmë e ka dorëzuar në gjykatë vendimin që NSH-ja ██████████ i ka paguar taksat për pronën në këtë rast. Ndërsa kontrata e vitit 1971 për transferimin e së drejtës së përdorimit e dorëzuar nga paditësi është në kundërshtim me aktvendimet e vitit 1979 dhe 1980 për pagesën e taksave.

Dokumentet vijuese ishin dorëzuar nga Paditësi:

1. Kopja e kontratës mbi transferimin e së drejtës së përdorimit Ov.br 213/71 e lidhur në mes të Kombinatit Bujqësor nga Vushtrria dhe Ndërmarrjes ██████████ më 7 qershor 1971;
2. Kopja e kontratës mbi transferimin e së drejtës së përdorimit të pronës së patundshme nr. 464 e lidhur në mes të Ndërmarrjes "██████████" dhe Komunës së Vushtrrisë më 8 korrik 1976;
3. Kopja e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë regjistrimi Fi-832/89;
4. Kopja e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë regjistrimi Fi-2830/93; Kopja e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë regjistrimi Fi-569/96;
5. Kopja e aplikimit për regjistrimit të Biznesit të përkohshëm të IT "██████████" brenda Administratës së Përkohshme Civile të KB-së;
6. Vendimi i Bordit mbikëqyrës i datës 2 nëntor 1999 lidhur me emrin e IT "██████████".
7. Kopja e fletës poseduese nr. 471 Komuna Kadastrale e Vushtrrisë e datës 6 janar 1977;
8. Kopja e kopjes së planit të ngastrës kadastrale nr. 2254/1;
9. Kopja e përgjigjes së Drejtoratit për kadastër dhe gjeodezi të Komunës së Vushtrrisë e drejtuar tek udhëheqësi i ZR-së së AKM-së në Mitrovicë;
10. Kopja e Vendimeve të Bashkësisë Vetëqeverisëse për Banim nr. 1281/6 e datës 9 maj 1980 dhe nr. 1281/51 – 244 e datës 14 shkurt 1980, lidhur me pagesën e taksave për përdorimin tokës urbane.

Arsyetimi ligjor

Padia ngrit konfliktin në mes të 2 interesave: interesin e AKP-së në privatizimin e tokës dhe interesin e komunës për ndërtimin e shkollës në të njëjtën tokë.

Që të dy janë të barabartë. Nuk mund të thuhet se ndërtimi i shkollës duhet t'i jap komunës të drejtën për ta zënë tokën duke u thirrur interesin publik. Në ndërkohë interesi i AKP-së është gjithashtu pjesërisht publik – duke qenë se privatizimi është një procedurë publike dhe jo interes privat i AKP-së.

Konflikti ka lindur kur komuna filloi të bëjë zënien e tokës. Së pari, komuna e shpalli tokën të ketë interes publik. Ai vendim është pa ndonjë efekt mbi të drejtën e tokës kundër AKP-së. Për më tepër vendimi nuk i është dorëzuar AKP-së (AKP-ja deklaroi kështu dhe i padituri nuk ka e dëshmuar të kundërtën). Vendimi i vitit 2008 e ka efektin e vetëm që nëse komuna e merr të drejtën mbi tokën, ajo mund ta përdorë atë për qëllimin e deklaruar në vendim.

Komuna është munduar që të marrë të drejtën duke kërkuar ndarjen e tokës. AKP-ja është përgjegjës (në procedurën e tanishme) se asnjë dokument nuk i është bashkangjitur kërkesës – në momentin e parashtrimit të padisë – dhe se nuk ka asnjë kompetencë në ndarjen e tokës, duke cekur Rregulloren e UNMIK-ut 2006/5 – në momentin e parashtrimit të ankesës kundër aktvendimit për refuzimin e kërkesës për masë të përkohshme.

Pyetja tjetër është: a janë marrëdhëniet e palëve të drejtuara nga dispozita të përgjithshme të cilat rregullojnë të drejtat pronësore?

Qëllimi i Rregullores së UNMIK-ut është që t'i japë komunës të drejtën për të kërkuar ndarjen e tokës sipas kushteve të përshkruara në rregullore, dispozitat e veçanta që tejkalojnë rregullat e zakonshme të drejtave pronësore.

Kjo është arsyeja se përse në këtë lëndë gjykata ka gjetur se rregullat e veçanta për rregullimin e situatës për nevoja të komunave janë të zbatueshme.

Kjo është arsyeja se përse në këtë moment Gjykata konstaton që mungesa e të drejtës mbi tokën nuk duhet të vendoset pasi që Komuna e ka të drejtën për të filluar procedurën për kërkimin e ndarjes. Sigurisht që shpërdorimi me fillimin e ndërtimit të shkollës në mungesë të së drejtës mund të çojë drejt pagimit të dëmeve. Mirëpo marrja në konsideratë e faktit se posedimi i tokës është i justifikuar me anë të qëllimit i cili mund të çojë drejt dhënies së tokës dhe se AKP-ja nuk ka ushtruar kompetencat e saj administrative në këtë rast, nuk mund të merret në këtë moment asnjë masë kundër posedimit të tokës.

Gjykata mori parasysh kompetencën e saj për të vendosur në lidhje me padinë duke zgjidhur aspektet administrative para se të bëjë një veprim të tillë. I padituri i dërgoi kërkesën e vetë dhe Paditësi nuk e mori vendimin mbi kompetencat apo meritat ashtu siç përshkruhet në Ligjin e Procedurës Administrative. Gjykata nuk mund t'i zgjidh çështjen administrative si një çështje preliminare (pasi që nuk është marrë dhe nuk

është kundërshtuar asnjë vendim). Ekzistojnë pasoja të ndryshme juridike që dalin nga vendimi administrativ, kështu që AKP-ja duhet të ushtrojë kompetencën e saj ashtu siç përshkruhet në Ligjin e Procedurës Administrative – për lëshimin e një vendimi mbi procedurën e filluar administrative.

Pasi që sipërfaqja prej 1.79.00 ha është e zënë nga shkolla, interesi ligjor në posedim vërtetohet dhe parimi i marrëdhënieve të siguruara civile kërkon një vendim të tillë. Dallimi në regjim i të 2 sipërfaqeve – e zëna dhe pjesa tjetër e ngastrës – është se në pjesën e zënë Komuna – e supozuar me bona fide – ka filluar transformimin e tokës duke marrë rrezikun mbi vete. Duke lexuar aktvendimin e vitit 2008, Gjykata nuk ka mundur të gjejë dëshmi të mala fide pasi që vendimi vetëm vërteton situatën ashtu siç është shkruar në dokumentet e regjistrimit. Për këtë arsye në këtë sipërfaqe ekzistojnë pasoja të drejtpërdrejta që dalin nga kompetencat administrative të AKP-së. Gjykata gjen se nuk ka asnjë arsye për zënie e pjesës së tjetër të tokës, ndërsa në pjesën e zënë të tokës, bilanci i kompensimit do të komplikohet shumë nëse do të vendosej për kthimin e tokës deri në përfundimin e procedurës administrative.

Sa i përket pjesës së tjetër të tokës që nuk është e zënë nga shkolla (dhe oborri) me këtë vendim gjykata do të vendos për kthimin e saj. Pasi që zënia është konstatuar si shkaktare për pagesën e dëmeve në këtë moment – edhe nëse ato do të kompensoheshin për shkak të mungesës së përgjigjes nga paditësi – Gjykata gjen se nuk ka arsye për të mbajtur pasigurinë në lidhje me këtë pjesë të tokës. Sipërfaqja e pazënë do të i nënshtrohet procedurave administrative por asnjë arsye nuk është gjetur në këtë moment që të Paditurit i është dhënë në posedim.

Sa i përket mbrojtjes së të paditurit, Gjykata e ka refuzuar atë. Kontrata nga viti 1971 dëshmon të drejtën e AKP-së për të administruar tokën si një aset i NSH-së. Sipas ligjit të zbatueshëm në kohën e kontratës, prona e patundshme në pronësi shoqërore, nënkupton vetëm të drejtën për ta përdorur pronën e patundshme. Me krijimin e AKM-së, qeverisja e pronës është bërë në atë mënyrë sa që e drejta e pronës – e mbajtur në atë kohë nga komunat – është transferuar tek AKM-ja pasi që e drejta për t'i shitur asetet i është kaluar AKM-së. Aktvendimet e treguara nga i Padituri – të viteve 1979 dhe 1980 – dëshmojnë vetëm obligimin e NSH-së për të paguar taksat vendore (shumat e shkruara si borxhe të NSH-së ndaj komunës janë kontribute për përdorimin e tokës si borxhe fiskale dhe jo si një çmim për shfrytëzimin e tokës).

Sa i përket emrit të NSH-së, Gjykata ka vërtetuar që të gjitha dokumentet dëshmojnë se Ndërmarrja për Prodhimin e Rrobave “██████” (ashtu siç është shkruar në kontratë nga viti 1971 dhe në fletën poseduese nga viti 2004) është riemëruar si IT ██████ (e dëshmuar me anë të vendimit Bordit Mbikëqyrës të vitit 1999).

Sikurse me aktvendimin e marrë në lëndën ASC 09-0020 Paditësi lirohet nga taksat gjyqësore. Prandaj, një vendim mbi shpenzimet gjyqësore nuk do të duhej të merrej.

Laura Plesa, Gjyqtare Kryesuese e EULEX-it

Sabri Halili, Gjyqtar

Tobias Lapke, Regjistruer i EULEX-it

